



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2023-011

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës - Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 par. 1 nënpar. 1.2 dhe par. 6 të Ligjit nr.06/L-057 “Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga B.H., për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, më 12.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paraqitur nga B.H., ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë – A.Sh.R..

A r s y e t i m

Ankuesi B.H., nga P., me 1 qershor 2023, në këtë gjykatë si autoritet kompetent ka paraqitur ankesë ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë – A.Sh.R..

Sipas ankuesit, kryetarja ka kryer shkelje disiplinore nga dispozita e nenit 3, 4 lidhur me nenin 5 par.1 nënpar.1.2, 1.3 lidhur me par.2 nënpar.2.1, 2.2, 2.5, 2.6, 2.9, 2.13 lidhur me dispozitat e nenit 9 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sipas ankuesit me 19.04.2023 ka paraqitur kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj gjyqtarit A.K., për shkak të shkeljeve të parimeve bazë të etikës profesionale si parimit të pavarësisë, parimit të paanshmërisë, barazisë dhe integritetit. Kryetarja me 17.05.2023 ka nxjerrë parashtrësë të titulluar “përgjigje në kërkesë datë 17.05.2023 me numër GJA.nr.446/2023 date 17.05.2023”, dhe këtë përgjigje nuk e mbështet në asnjë dispozitë ligjore dhe ka renë nën ndikimin e gjyqtarëve duke bërë komunikim “ex- partë” me gjyqtarët, si një komunikim i pahijshëm dhe i palejuar. Në rastin konkret ka qenë e ndikuar, e nxitur ka pas trusni, kërcënime apo ndërhyrje të jashtme të drejtpërdrejta apo të tërthorta nga gjyqtarët, dhe ka bërë anime në favor të gjyqtarit A.K.. Përdorimi i inicialeve për gjyqtarët e gjykatës ka krijuar dyshimin e arsyeshëm se përgjigja në kërkesë është nxitur nga motivet tjera përtej zbatimit të ligjit. Sipas ankuesit kryetarja e ka trajtuar në mënyrë diskriminuese në bazë të

mendimeve politike ose tjera, prejardhjes kombëtarë, gjendjes ekonomike sociale, lindjes, aftësive të kufizuara ose ndonjë statusi tjetër personal dhe ia ka pamundësuar të drejtën që t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tija të ligjshme. Në veprimet e saj janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar. Kërkon që zyrtarisht çështja t'i referohet prokurorit të shtetit apo avokatit të popullit.

Megjenëse ankuesi përveç pretendimeve për shkelje disiplinore konsideron së këto veprime konsumojnë edhe vepër penale si autoritet kompetent fillimisht kam shqyrtuar ankesën në këtë drejtim dhe pas shqyrtimit të bazës faktike dhe juridike të shkeljes së supozuar disiplinore në drejtim të elementeve të veprës penale vlerësoj se shkelja e supozuar disiplinore nuk përmban elemente të veprës penale, prandaj çështjen nuk e kam referuar tek prokurori i shtetit por kam filluar shqyrtimin për shkeljet e pretenduara disiplinore.

Me qëllim të vërtetimit bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj të pretendimeve sa i përket shkeljeve disiplinore si autoritet kompetent kam kërkuar nga kryetarja e gjykatës që të deklarohet lidhur me këtë rast dhe kam pranuar deklaratën e të njëjtës.

Kryetarja në deklaratën e saj thekson se qëndron fakti se me 24.04.2023, e ka pranuar ankesën nga ankuesi B.H., për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.K., me pretendim se ka shkelë parimin e gjykimit në kohë, zvarritje të procedurës dhe mohim të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Sipas tij nëna e tij (e cila ka vdekur me 28.10.2017) ka ushtruar padi subsidiare në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër B.H., F.Z., N.M., ..etj, për shkak të dyshimit se kanë kryer vepër penale tortura, nga neni 158, shpërdorim i pozitës zyrtare, përvetësim në detyrë.. etj. Sipas ankuesit gjyqtari A.K., nuk ka vepruar në këtë çështje deri me 7.04.2023 kur edhe e ka nxjerrë aktvendimin për plotësim të padisë – aktakuzës, dhe i janë dashur dhjetë vite për të vepruar në këtë çështje penale, dhe me këto veprime të i njëjti ka shkaktuar cenim të dinjitetit dhe ka krijuar një mjedis frikësues duke mos respektuar parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë. Pas paraqitjes së kërkesës menjëherë ka kërkuar shkresat e lëndës PKR.nr.879/2013 dhe ka marrë deklaratë me shkrim nga gjyqtari A.K.. Sipas shkresave të kësaj lënde del se përveç padisë subsidiare në shkresa është edhe një ftesë për seancë lëshuar nga gjyqtari V..I., me 13.12.2016 të cilën nuk ka dëshmi se e ka pranuar i pandehuri dhe as dëshmi se është mbajtur seanca, dhe një vërtetim të datës 8.12.2014 për të pandehurin B.H., që e kishte lëshuar i njëjti gjyqtar. Kurse nga deklarata e gjyqtarit A.K., rezulton se i njëjti këtë lëndë e ka pranuar në zyrën e tij me 5.04.2023 dhe pas pranimi të lëndës dhe shqyrtimit të saj me 7.04.2023 ka kërkuar nga pala e dëmtuar sqarime shtesë apo plotësim të padisë, por që nuk ka marrë përgjigje nga pala dhe pas kalimit të afatit 15 ditor do të ndërmer veprime procedurale tjera. Pasi që ka vërtetuar se nuk ka elemente të shkeljes disiplinore nga ana e gjyqtarit ka kërkuar informacione shtesë se ku ka qenë lënda deri në këtë kohë. Nga dosja e lëndës ka kuptuar se kjo lëndë ka qenë tek gjyqtari i departamentit të përgjithshëm A.K., dhe nga i njëjti ka kërkuar që të deklarohet me shkrim për këtë çështje. Sipas deklaratës së këtij gjyqtari lëndën e kishte pranuar me 3.09.2020, mirëpo meqë ishte gjyqtar fillestar dhe kishte një numër të madh të lëndëve të cilat kanë qenë afër parashkrimit absolut dhe relativ si dhe lëndë të natyrës urgjente të njëjtën e kishte planifikuar ta procedoj në muajin maj të vitit 2023, mirëpo pas shqyrtimit paraprak të padisë ka vlerësuar se kjo çështje për shkak të natyrës së veprave bie në kompetencë të Departamentin e Krimeve të Rënda dhe me 5.04.2023 e kishte deleguar lëndën

në kompetencë të këtij departamenti. Meqë kërkesa e ankuesit në lidhje me shkeljet e gjyqtarit A.K., nuk ishte e bazuar, ankuesit i është përgjigje me parashtrësë duke ia sqaruar situatën dhe njoftuar për veprimet e gjyqtarit të çështjes, por edhe për veprimet e gjyqtareve tjerë në këtë çështje. Si kryetare e gjykatës ka të drejtë të komunikoj me gjyqtarë sepse këtë nuk ja ndalon asnjë dispozitë ligjore dhe kjo s'ka të beje asgjë me komunikim "ex – partë", ngase nuk është palë në procedurë. Nuk e ka mbrojtur gjyqtarin A.K., ngase sipas shkresave të lëndës del se ai ka vepruar me kohë në këtë çështje, dhe në veprimet e tij nuk ka asnjë element të shkeljes disiplinore, kurse nuk e kupton pretendimin e ankuesit se ka qenë e ndikuar nga jashtë dhe ka qenë e njëanshme, nëse një gjë e tillë ekziston ai është dashur ta argumentojë. Në fakt ankuesi asnjëherë deri me tash nuk ishte interesuar për këtë çështje dhe nuk i kishte treguar gjykatës së nëna e tij që ka ngritë akuzë ka vdekur para gjashtë viteve. Po ashtu, është evidente se lënda nuk është trajtuar me kohë por jo për shkakun e saj dhe as gjyqtarëve që kanë vepruar tani, ngase lënda ndër vite kishte kaluar nëpër duart e shumë gjyqtarëve. Arsyeja pse ka përdor inicialet e gjyqtareve është se meqë gjyqtarët A. K., e V.I., nuk kanë qenë subjekt i ankesës nuk ka dashur t'ua lakoj emrat në përgjigjen e dhënë, ndërsa ndaj të tjerëve nuk ka mundësi të veproj pasi që nuk janë pjesë e kësaj gjykate. Konsideron se e i ka ndërmarrë të gjitha veprimet konform përgjegjësive sa i përket shqyrtimit të kërkesës madje duke ia dhënë mundësin ankuesit të ndërmarrë veprime ndaj të tjerëve që e kanë mbajtur lëndën ndër vite. Meqë gjyqtari i çështjes kishte vepruar me kohë kërkesën e tij e ka konsideruar si parashtrësë dhe për këtë i ka dhënë përgjigje me shkrim. Ka kërkuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar. Deklaratës ia ka bashkëngjitur aktakuzën e paditësit supsidiar datë 19.10.2012, ftesën për datë 13.12.2016, vërtetimin e datës 8.12.2014, kërkesën e ankuesit datë 24 prill 2023, përgjigjen në kërkesë datë 17.05.2023, certifikatën e vdekjes së paditëses supsidiare M.H., shkresën e datës 7.04.2023 të gjyqtarit A.K., me të cilën është kërkuar plotësimi i padisë supsidiare, shkresën e datës 5.04.2023 të gjyqtarit A.K., me të cilën është kthyer lënda në Departamentin e Krimeve të Rënda.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së kryetares dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur deklaratës, vlerësojë se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur procedurë disiplinore.

Si autoritet kompetent, vlerësoj se ankesa është dukshëm joserioze, ngase neni 3 e 5 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve nuk i referohet shkeljeve disiplinore, e përveç kësaj ankuesi pretendon se në veprimet e kryetares janë konsumuar shkeljet disiplinore parashikuar me nenin 5 par.2 pika 2.1, 2.2, 2.5, 2.6, 2.9, 2.13 të ligjit të lartcekur, por këto shkelje nuk i argumenton. Në fakt arsyetimi në këtë drejtim është i paqartë dhe nuk mund të kuptohet se çka ka dashur të thotë ankuesi. Kështu, sipas ankuesit përgjigjja e kryetares ndaj kërkesës së tij është dhënë nga ndikimi i gjyqtarëve dhe me këtë kryetarja ka bërë komunikim "ex –partë", por një pretendim i tillë është joserioz, ngase komunikimi "ex - partë" nënkupton çfarëdo forme të komunikimit ndërmjet një gjyqtari dhe njëres prej palëve në procedurë gjyqësore apo një pale tjetër lidhur me rastin konkret gjyqësor, pa prezencën, pjesëmarrjen ose dijeninë e palës tjetër ndërgjyqësorë. Kryetarja e Gjykatës në rastin konkret nuk ka qenë palë në procedurë, e përveç kësaj nuk e ka të ndaluar të komunikoj me gjyqtarët e gjykatës të cilën ajo e menaxhon. Pastaj, pretendohet se ajo ka qenë e ndikuar nga gjyqtarët, e ndikuar politikisht dhe ka pasur trysni me rastin e dhënies së përgjigjes por një gjë e tillë nuk

argumentohet. Kurse, fakti se ajo në përgjigjen e dhënë i është referuar gjyqtareve të cilët nuk kanë qenë pjesë apo subjekt i kërkesës së ankuesit nuk paraqet shkelje disiplinore.

Pastaj, nuk del të jetë i bazuar as pretendimi se kryetarja ka bërë anime në favor të gjyqtarit A.K., ngase nga shkresat e kësaj çështje, del se ky gjyqtar si gjyqtar i çështjes në lëndën ku nëna e ankuesit është paditës subsidiar duke pasur parasysh kohën kur është ngarkuar me këtë lëndë ka vepruar me kohë, fakt ky që vërtetohet nga veprimet e ndërmarra, lëndën e ka pranuar me 5.04.2023 gjë që vërtetohet nga shkresa me të cilën kjo lëndë i është dorëzuar departamentit të krimeve të rënda, kurse me 7 prill 2023 ka kërkuar plotësimin e akuzës respektivisht padisë supsiadiare.

Nga një gjendje e tillë e fakteve, si autoritet kompetent vlerësoj se pretendimet lidhur me shkeljet e bëra nga subjekti i hetimit nuk janë provuar, andaj, në mungesë të fakteve të provuara mbi bazën e të cilave do të mund të kualifikohej shkelja e pretenduar konsideroj se nuk ka vend për fillimin e hetimeve disiplinore, ashtu siç pretendon ankuesi.

Nga arsyet e cekura, e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.1 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.